
LATEST DEVELOPMENTS WITH REGARDS TO PROCEDURAL CONTESTS RELATED TO COURT COMPOSITION AND RESPONSE ON SUIT

Arben Agushi

College Biznesi, Prishtina, Kosovo

Abstract: The purpose of this scientific research paper is to review the provisions of the Law on contested procedure, regarding innovations in the composition of the court and responding to lawsuits in terms of case law. We aim to analyze the innovations contained in the Law on contested procedure in relation to property-legal relations, focusing especially on the legal gaps and shortcomings that appear here and there during the practical implementation of legal provisions and present difficulties in the work of judges and of other lawyers who deal professionally with the implementation of this law.

We hope that this scientific research paper will help lawyers, scholars and law students to create a clearer and more accurate vision of the concepts and legal institutions regulated by this law, as well as to expand knowledge during implementation in the life of daily legal practice, the more so than a study of this kind has been lacking so far in our legal literature.

Keywords: court composition, response on suit

ZHVILLIMET E FUNDIT P REGR KONKURSET PROCEDURALE LIDHUR ME POSRBOSRJEN E GJYKATS DHE PPRGJEGJSIN N S RREGULL

Arben Agushi

Kolegji Biznesit, Prishtinë, Kosovë

Abstrakt: Qëllimi i këtij punimi kërkimor shkencor është të rishikojë dispozitat e Ligjit për procedurën kontestimore, në lidhje me risitë në përbërjen e gjykatës dhe përgjigjen ndaj padive në aspektin e praktikës gjyqësore. Ne synojmë të analizojmë risitë e përfshira në Ligjin për procedurën e kontestuar në lidhje me marrëdhëniet juridiko-pronësore, duke u përqëndruar veçanërisht në boshllëqet ligjore dhe mangësitë që shfaqen këtu dhe atje gjatë zbatimit praktik të dispozitave ligjore dhe vështirësitë e tanishme në punën e gjyqtarëve dhe të avokatëve të tjerë që merren profesionalisht me zbatimin e këtij ligji.

Shpresojmë që ky punim kërkimor shkencor të ndihmojë avokatët, studiuesit dhe studentët e drejtësisë për të krijuar një vizion më të qartë dhe më të saktë të koncepteve dhe institucioneve ligjore të rregulluara nga ky ligj, si dhe për të zgjeruar njohuritë gjatë zbatimit në jetën e praktikës së përditshme juridike, më shumë sesa një studim i këtij lloji ka munguar deri më tani në literaturën tonë juridike.

Fjalët kyçe: përbërja e gjykatës, përgjigja me padi

1. HYRJE

Në këtë punim do të shqyrtohet përbërja e gjykatës, përgjigja në padi sipas Ligjit për procedurës kontestimore i Kosovës në vijim LPK-së në dispozita ligjore sjell risi për sa i përket përbërjes së gjykatës si prezumim absolut procedural për gjykim të drejtë dhe të ligjshëm. Kur është fjala për vendosje lidhur me mjetin e jashtëzakonshëm juridik-propozimin për përsëritjen e procedurës tash gjykata e shkallës së parë gjykon në përbërje prej gjykatësit të vetëm, kurse në shkallë të dytë gjykata gjykon po ashtu në përbërje prej një gjykatësi profesional. Në dispozitat e këtij ligji kërkohet si kusht i vetëm që gjykatësi i cili do të vendos në shkallë të dytë nuk duhet të ketë marr pjesë në marrjen e vendimit në gjykatën e shkallës së parë. Po ashtu në procedurë të posaçme lidhur me kontestin nga marrëdhënie e punës, pengimi në posedimi në kontestet e vlerës së vogël, dhënies së urdhërpagesës dhe procedura e kontesteve tregtare gjykata e shkallës së parë gjithashtu gjykon në përbërje prej gjykatësit të vetëm.

Një risi tjetër ka të bëjë me përbërjen e Gjykatës Supreme të Kosovës kur vendos për revizionin. Përbërja e gjykatës tash është në përbërje prej tre gjykatësve profesional e jo si me Ligjin e mëparshëm mbi procedurën kontestimore, kur kolegji përbëhej prej pesë gjykatësve profesional.

Këto risi të përcaktuara me LPK-në kanë një rëndësi të madhe lidhur me thjeshtësimin dhe ekonomizimin e procedurës dhe respektimi i tyre është kusht i domosdoshëm për marrjen e vendimeve të drejta dhe të ligjshme.

Gjatë përpilimit të punimit kemi përdor disa norma juridike ku veçojmë metodën normative e cila më ka ndihmuar në interpretimin dhe gjetjen e kuptimësisë të normës konkrete juridike dhe metodën krahasuese e cila më ka ndihmuar në gjetjen e risive konkrete të LPK-së duke krahasuar me ligjet e mëparshme të cilat ishin në fuqi deri në miratimin dhe hyrjen në fuqi të LPK-së të Republikës së Kosovës.

2. PËRBËRJA E GJYKATËS

Përbërja e gjykatës rregullohet edhe në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës¹⁹⁶. Gjithashtu gjykata vendos në trup gjykues në përbërje prej një gjykatësi profesional dhe dy gjykatës joprofesional – porotë, ndërsa kolegjin gjykues e përbëjnë tre gjykatës profesional.

Me përbërje të gjykatës kuptojmë përbërjen në të cilën ajo gjykon, domethënë vendos për themelësinë e kërkesëpadisë apo për mjetin e goditjes së vendimeve gjyqësore¹⁹⁷.

Në procedurën kontestimore përbërja e rregullt e gjykatës paraqet prezumim procedural i cili ka të bëjë me gjykatën. Klasifikimin e prezumimeve procedurale e bënë shkencë juridike pasi që është detyrë e saj, ngase Kodet e procedurës civile, e as Ligjet e procedurës Civile këtë klasifikim nuk e kanë bërë.¹⁹⁸

Përbërja e rregullt e gjykatës në praktikën gjyqësore paraqet prezumim - kusht për rrjedhën e ligjshëm të procedurës kontestimore. Kur gjykata në procedurën kontestimore gjykon në përbërje jo të rregullt ajo në këtë mënyrë bënë shkelje qenësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 al.2 pika a) e LPK-së për të cilat gjykata e shkallës së dytë në procedurën ankimore është e detyruar të kujdeset kryesisht (ex officio) dhe vetëm për këtë shkak vendimi gjyqësor prishët, kurse çështja i kthehet në ri procedurë gjykatës së shkallës së parë.

Nga kjo rrjedh se përbërja e rregullt e gjykatës është njëra nga prezumimet më të rëndësishme për rrjedhën e ligjshme të procedurës kontestimore lidhur me një çështje kontestuese e cila bie në kompetencë lëndore, territoriale apo funksionale të gjykatës së shkallës së parë, dytë apo gjykatës e cila gjykon lidhur me mjetet e jashtëzakonshme juridike.

Me ligjin e mëparshëm të LPK-së, i cili sipas Rregullores së UNMIK-ut, nr.1999/24 për Ligjin e zbatueshëm në Kosovë, përbërja e gjykatës në procedurën kontestimore është rregulluar me dispozitën e nenit 41¹⁹⁹. Me këtë dispozitë është parapa se gjykata e shkallës së parë gjykon në trup gjykues në përbërje prej një gjykatësi profesional dhe dy gjyqtar joprofesional-porotë si dhe në përbërje prej gjykatësit të vetëm individual.

Ligji për procedurën Kontestimore i Republikës së Kosovës (në vijim LPK), përbërjen e gjykatës e ka rregulluar me dispozitat e nenit 15²⁰⁰. Me këtë dispozitë është parapa se gjykata e shkallës së parë në procedurën kontestimore dhe procedurën lidhur me mjetin e jashtëzakonshëm juridik-propozimin për përsëritjen e procedurës gjykon në përbërje prej gjykatësit të vetëm²⁰¹.

LPK-ja sjellë risi për sa i përket përbërjes së gjykatës si prezumim absolut procedural për gjykim të drejtë dhe të ligjshëm, e cila risi shprehet në at se gjykata e shkallës së parë gjykon në përbërje prej gjykatësit të vetëm, ndërsa trupi gjykues është eliminuar.

Në procedurën kontestimore lidhur me mjetin e rregullt juridik-ankesën, gjykata e shkallës së dytë gjykon në kolegji i cili përbëhet prej tre gjykatësve profesional, kurse sipas dispozitave të nenit 235 të LPK-së lidhur me propozimin për përsëritjen e procedurës gjykon gjykata e shkallës së dytë në përbërje prej një gjykatësi i cili nuk ka marrë pjesë në nxjerrjen e vendimit të gjykatës së shkallës së dytë në procedurën e mëparshme për të njëjtën lëndë.

Gjithashtu, LPK-ja sjellë risi edhe për sa i përket përbërjes së Gjykatës Supreme të Kosovës për të vendosur lidhur me revizionin. Me dispozitatat e nenit 15 al.2 të LPK-së është paraparë se lidhur me revizionin vendos kolegji në përbërje prej tre gjykatësve profesional²⁰², ndërsa me ligjin e mëparshëm kolegji ka qenë i përbërë prej pesë gjykatësve profesional.

Duhet të theksohet se ligji nuk e përdorë shprehjen “kolegj”, por e përdorë shprehjen “trup”. Shprehja kolegji është më e drejtë, me arsytim se kolegjin e përbëjnë gjykatësit profesional, kurse trupin e përbënë një gjykatës profesional dhe dy gjyqtarë joprofesional-porotë. Ky mendim bazohet edhe në praktikën gjyqësore të paraluftës dhe pas luftës në Republikën e Kosovë.²⁰³

Edhe pse me dispozitatat e nenit 15 al. 2 të LPK-së nuk flitet për përbërjen e Gjykatës Supreme të Kosovës për të vendosur lidhur me mjetin e jashtëzakonshëm juridik-kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, mendoj se lidhur me këtë mjet juridik Gjykata Supreme e Kosovës do të duhej të gjykon në kolegji gjykues në përbërje prej tre gjykatësve²⁰⁴.

¹⁹⁶ Kushtetuta e Republikës së Kosovës e miratuar nga Kuvendi i Kosovës në vitin 2008. neni 102.

¹⁹⁷ Prof.dr. Faik Brestovci, E drejta procedurale Civile, Prishtinë.2002, fq.27.

¹⁹⁸ Prof.dr. Enver Hasani, Ne bis in idem në procedurën Kontestimore, Prishtinë 2010. fq 21.

¹⁹⁹ Ligji mbi procedurën Kontestimore i vitit 1977 Gaz. Zyrt e RSFJ. 4/77,36/80,69/82,58/84,74/87,57/89,20/90 dhe 27/90, më tej shkurt LPK-së neni 41.

²⁰⁰ Prof.dr.iur.Iset Morina LLM/Avokat Selim Nikqi Komentar – Ligji për procedurën Kontestimore Prishtinë 2012.fq.47.

²⁰¹ Ligji për procedurën Kontestimore është publikuar në (“Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës” nr.38/2008) me dt.20.09.2008 dhe ka hy në fuqi pas 15 dite nga dita e publikimit-me dt.06.10.2008 më tej shkurt LPK-së në nenin 15.

²⁰² Ligji për procedurën Kontestimore i Republikës së Kosovës neni 15 al.2.

²⁰³ Gjykata Supreme e Kosovës Buletini i Praktikës Gjyqësore viti 1999-2002, Aktvendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.nr.53/2001 me 13 nëntor 2001, Aktvendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.nr.66/2001 më 27.12.2001, Aktvendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.nr.40/2002 me 02.07.2002.

²⁰⁴ Ligji për procedurën Kontestimore i Republikës së Kosovës neni 15 al.2.

Në çështjet kontestuese të cilat kanë të bëjnë me kontestet nga marrëdhëniet e familjare, pronësisë intelektuale dhe asaj industriale, gjykatat e shkallës së parë duhet të gjykojnë në përbërje sikurse është paraparë me ligje të veçanta²⁰⁵. Kjo zgjedhje është bazuar në parimin - standardin juridik se ligji i veçantë e shfuqizon ligjin e përgjithshëm (lex specialis abrogata lex generalis)

Derisa me dispozitat e nenit 73 të Ligjit për familje të Kosovës është paraparë se në çështjet kontestuese martesore në gjykatën e shkallës së parë gjykon trupi gjykues, kurse në shkallën e dytë kolegji prej tre gjykatësve²⁰⁶, kurse Ligji për të drejtat e autorit dhe të drejtat tjera të përafërta nuk e ka rregulluar me asnjë dispozitë përbërjen e gjykatës²⁰⁷, andaj për gjykimin e kontesteve të kësaj natyre mendoj se përbërja e gjykatës do të jetë në pajtim me dispozitën e nenit 15 al.1 të LPK-së.

Në proceduarat e posaçme dhe at: në kontestet nga marrëdhënia e punës, pengimit në posedim, kontestet e vlerës së vogël, dhënies së urdhërpagesës dhe procedurën e kontesteve tregtare, gjykata e shkallës së parë gjykon në përbërje prej gjykatësit të vetëm²⁰⁸.

Vlen të theksohet se në nenin 296 të LPK-së është se: vendimin mbi masën e sigurimit e jep gjykata që vepron në shkallë të parë, kurse gjykata më e lartë atëherë kur propozimi për marrjen e saj është paraqitur pas dërgimit të dosjes së lëndës sipas ankesës në këtë gjykatë. Pra gjykata e shkallës së parë lidhur me propozimin për sigurimin e kërkesëpadisë vendosë në përbërje prej gjykatësit të vetëm, kurse LPK-ja me asnjë dispozitë nuk e ka rregulluar përbërjen gjykatës së shkallës më të lartë (bëhet fjalë për gjykatën Qarkut - Apelit dhe gjykatën Supreme) për të vendosur lidhur me propozimin për sigurimin e kërkesëpadisë kur dosja e shkresave të lëndës sipas ankesës i dërgohet për gjykim gjykatës së shkallës së lartë, përkatësisht gjykatës së Qarkut – Apelit apo asaj Supreme kur vepron si gjykatë e shkallës së dytë. Në këtë vakum juridik për sa i përket përbërjes së gjykatës më të lartë për të vendosur lidhur me propozimin për sigurimin e kërkesëpadisë në praktikën gjyqësore është paraqitur mendimi se lidhur me propozimin për sigurimin e kërkesëpadisë gjykata e shkallës së dytë vendos në përbërje prej gjykatësit të vetëm ngjashëm sikurse në gjykatën e shkallës së parë²⁰⁹.

3. PËRGJIGJA NË PADI

Përgjigja në padi me LPK-në e mëparshme është rregulluar me dispozitat e nenit 285. Kryetari i trupit gjykues apo gjykatësi i vetëm ka vlerësuar se a do të kërkoj nga i padituri që të paraqes përgjigje në padi apo jo. Kur një gjë e tillë nuk është kërkuar i padituri ka mund të paraqes vet përgjigjeje në padi. Paraqitja e përgjigjes në padi apo mos paraqitja e përgjigjes në padi brenda afatit prej 15dite të cilin e ka caktuar kryetari i trupit gjykues nuk ka shkaktuar pasoja procedurale. Seanca përgatitore ose ajo kryesore është caktuar në qoftë se janë plotësuar kushtet-prezumimet tjera të parapara me ligj.

Me LPK-në e Republikës së Kosovës, përgjigja në padi ka marr një cilësim dhe një përmbajtje tjetër procedural dhe në krahasim me ligjin e mëparshëm kjo është ngrit në pedestalin e një veprimi të detyrueshëm procedural të paditurit. Pra detyrimi i të paditurit për të paraqitur përgjigje në padi është risi e plotë e LPK-së.

Me dispozitat e nenit 387 të LPK-së është paraparë se me qëllim që çështja të përgatitet më mirë për tu zgjidhur shpejtë e drejtë, gjykata që nga momenti i paraqitjes së padisë e deri te momenti i caktimit të seancës së shqyrtimit kryesorë të çështjes me aktvendim vendosë për dhënien e përgjigjes në padi. Lidhur me këtë mendoj se aktvendimi për dhënien e përgjigjes në padi duhet të përmbaj të gjitha elementet e parapara me dispozitat e nenit 160 të LPK-së. Dispozitivi i aktvendimit do të përmban udhëzimet e parapara me dispozitat e nenit 395, 396, 397,99, 102,150 al.1 pika a), b), c) 77 al.2 dhe 93 al.1 të LPK-së. Arsyetimi i aktvendimit do të jetë shumë i shkurt dhe në të do të theksohen vetëm dispozitat ligjore të cilat u theksuan më lart. Aktvendimi do ta përmban edhe udhëzimin juridik në të cilin do të udhëzohen palët se kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa. Këtij aktvendimi do ti bashkëngjitet padia e rregullt dhe e plotë me të gjitha shkresat e bashkangjitura padisë dhe do ti dërgohen të paditurit për përgjigje në padi. Nga kjo rrjedh se padia jo e plotë dhe e parregullt nuk mund ti dërgohet të paditurit për të paraqitë përgjigje në padi.

Përgjigja në padi paraqet një shkresë-parashtresë të cilën e paraqet i padituri brenda afatit prej 15 dite nga dita e dorëzimit të aktvendimit për përgjigje në padi. Në pajtim me dispozitat e nenit 99 al.2 dhe 3 të LPK-së, përgjigja në padi sikurse padia duhet të jetë e kuptueshme dhe si e tillë duhet të përmbaj çdo gjë që nevojitet dhe e bënë të mundur veprimin-gjykimin sipas saj. Me dispozitat e nenit 397 të LPK-së është paraparë se gjykata vepron sipas nenit 102 të LPK-së po që

²⁰⁵ Ligji për Familjën i Kosovës, Ligji nr. 2004/32, neni 73, fq. 14.

²⁰⁶ Po aty neni 73.

²⁰⁷ Ligji për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të përafërta, Ligji nr.2004/45.

²⁰⁸ Shih më gjërsisht:Ligjin e procedurës Kontestimore LPK-së, kreu XXVI, procedura në kontestet nga marrëdhënia e punës,neni.474,kreu XXVII, procedura në kontestet për shkak të pengimit të posedimit,neni.478,kreu XXVIII, procedura në kontestet e vlerës së vogël,neni.484,kreuXXIX,procedura e dhënies së urdhërpagesës,neni.492,kreu XXX, procedura në kontestet tregtare,neni.505,në vijim LPK-së,faqe.137-146.

²⁰⁹ Trefzë në nivel ekspertësh mbajtur në Institutin Gjyqësor të Kosovës (IGJK), Prishtinë me dt.23.03.2011.

se konstaton se përgjigja në padi është e pa kuptueshme apo jo e plotë, me qëllim të heqjes së mungesave të këtylla. Ligji ka mangësi për sa i përket pasojave procedurale kur përgjigja në padi brenda afatit të caktuar nuk i kthehet gjykatës dhe kur ajo i kthehet e pa rregulluar dhe e pa plotësuar.

Duke marr për bazë faktin se mos paraqitja e përgjigjes në padi shkakton pasoja procedurale për të cilat në vazhdim do të bëjmë fjalë, mendoj se kur të paditurit i kthehet në përmirësim apo plotësim përgjigja në padi dhe ai nuk e bënë përmirësimin apo plotësimin e saj brenda afatit të caktuar kjo nuk mund të konsiderohet si e tërhequr e as të hedhet poshtë. Ky mendim bazohet në arsyetimin se tërheqja konsiderohet sikurse i padituri të mos ketë paraqit përgjigjeje në padi, ndërsa hedhja poshtë e pengon zhvillimin e procedurës kontestimore në gjykatën e shkallës së parë, sepse gjykata nuk lëshohet fare në shqyrtim dhe me këtë veprim të paditurit ia bënë të pamundur realizimin e të drejtës së përgjigjes në padi.

Nga kjo që u paraqit më lart rrjedh përfundimi se në situatën e tillë juridike nuk mund të zbatohen dispozitat e nenit 102 al.3 dhe 4 të LPK-së por gjykata do të veproj në pajtim me dispozitat e nenit 400 al.1 dhe 2 të LPK-së dhe do të cakton seancën përgatitore. Kjo seancë si rregull mbahet më së voni brenda afati prej 30 ditësh nga dita kur gjykatës i ka arritur përgjigja në padi. Mendoj se në rast kur i padituri nuk e ka paraqitur brenda afatit të caktuar përgjigjen në padi e cila i është kthyer të paditurit me aktvendim për përmirësim dhe plotësim, afati për caktimin e seancës përgatitore prej 30 dite do të llogaritet nga dita kur i padituri ka qenë i detyruar që t'ia paraqes gjykatës përgjigjen në padi të përmirësuar dhe të plotësuar.

Mosparaqitja e përgjigjes në padi ka për pasojë nxjerrjen e aktgjykimit për shkak të pa dëgjueshmërisë - mosbindjes në qoftë se plotësohen kushtet e parapara me dispozitat e nenit 150 al.1 pika a), b), c) të LPK-së. Ndërsa, po që se i padituri me përgjigje në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundër kontestimit të kërkesëpadisë, gjykata në pajtim me dispozitat e nenit 152 lidhur me nenin 143 dhe 147 të LPK-së pa caktuar seancë gjyqësore mund të nxjerr aktgjykim pa shqyrtim kryesorë të çështjes.

Gjithashtu, me dispozitat e nenit 278 al. 1 të LPK-së të mëparshme janë paraparë autorizimet e kryetarit të trupit gjykues, përkatësisht gjykatësit të vetëm. Pas shqyrtimit paraprak të padisë kryetari i trupit gjykues – gjykatësi i vetëm ka vendosur lidhur me të gjitha prezumimet negative procedurale të cilat e kanë penguar rrjedhën e procedurës kontestimore. Gjykatësi i vetëm ose kryetari i trupit gjykues ka ndërmarr masa të parapara me ligj dhe ka vendos lidhur me çështjet të cilat kanë ndikuar në drejtimin e ligjshëm të procedurës kontestimore²¹⁰.

Ligji për procedurën Kontestimore, autorizimet e gjykatësit të vetëm të cilat kanë të bëjnë me përgatitjen e seancës për shqyrtim kryesor i ka parapara me dispozitat e nenit 387 dhe 388. Për sa i përket autorizimeve të gjykatësit të vetëm për përgatitjen sa më të mirë të procedurës dhe për tu zgjidhur çështja kontestuese pa zvarritje, LPK-ja sjellë risi në dispozitat e nenit 387 al. 1 pika a). Përveç kësaj në al. 1 pika 1. të njëjtit nen është paraparë autorizimi i gjykatësit për të caktuar masat e përkohshme të sigurimit²¹¹.

LPK-ja në kreun e XXI këto risi i emërton “sigurim i kërkesëpadisë” dhe pastaj procedurën për vendosjen lidhur me propozimin për sigurim të kërkesëpadisë e rregullon me dispozitat e nenit 296 deri në nenin 318.²¹²

Gjithashtu në al.1 pika (u) dhe (v) të njëjtit nen është paraparë se gjykatësi gjatë përgatitjes së seancës për shqyrtim kryesor vendos për jo kompetencën e gjykatës dhe pushimin e gjykimit kur hedhet padia apo kur ajo tërhiqet, si dhe të gjitha çështjet tjera të cilat kanë të bëjnë me drejtimin e procedurës.

Me dispozitat e nenit 387 al.2 ngjashëm sikurse LPK-ja i mëparshëm është paraparë se kundër të gjitha aktvendimeve që i nxjerr gjykatësi gjatë përgatitjes së seancës për shqyrtim kryesor të cilat kanë të bëjnë me drejtimin e procedurës nuk lejohet ankimi²¹³. Këto autorizime gjykatësi i ka edhe gjatë procedurës së shqyrtimit paraprakë të padisë.

Në nenin 389 të LPK-së është parapara se gjykata pas shqyrtimit paraprak të padisë mund të nxjerrë të gjitha aktvendimet e përmbajtura në nenin 392 të këtij ligji, përveç kur kemi të bëjmë me çështjet për të cilat për nga natyra e tyre, apo sipas dispozitave të këtij ligji aktvendimi mund të jepet vetëm në fazën e mëtejme të procedurës kontestimore²¹⁴.

4. PËRFUNDIMI

I. Nga shqyrtimet e bëra lidhur me çështjen: “Disa risi në procedurën kontestimore përkitazi me përbërjen e gjykatës dhe përgjigjen në padi” mbi bazën e krahasimit të dispozitave të ish Ligjit mbi procedurës Kontestimore i zbatueshëm në Kosovë sipas rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/24, për Ligjin e zbatueshëm në Kosovë i cili ka hyrë në fuqi në vitin 1977, (“Gazeta Zyrtare e RSFJ-së” nr.4/77), rrjedh përfundimi se Ligji për procedurën kontestimore i Republikës së Kosovës për

²¹⁰ Ligji mbi procedurën Kontestimore i vitit 1977 Gaz. Zyrt e RSFJ nr.4/77,36/80,69/82,58/84,74/87,57/89,20/90 dhe 27/90, LPK-së, neni 278 al.1.

²¹¹ Ligji për procedurës Kontestimore i Republikës së Kosovës neni 387 al 1 pika a) dhe 388 fq.113-115.

²¹² Po aty neni 296 – 318, fq.91 – 318.

²¹³ Po aty neni 387 al 2.fq.113- 114.

²¹⁴ Ligji për procedurën Kontestimore i Republikës së Kosovës neni 389 lidhur me nenin 392, fq.115 në vijim LPK-së.

sa i përket përbërjes së gjykatës dhe përgjigjes në padi, ka sjellë risi të mëdha të cilat janë bërë në pajtueshmëri me standardet më të larta juridike ndërkombëtare për gjykim të arsyeshëm dhe të drejtë të çështjes.

II. Ky punim do t'ju ndihmonte studentëve, gjyqtarëve dhe punonjësve të organeve të jurisprudencës që drejtpërdrejtë apo në mënyrë të tërthortë merren me aplikim praktik të normave juridike të LPK-së.

III. Risitë lidhur me përbërjen e gjykatës dhe përgjigjen në padi janë konform me parimet themelore të procedurës kontestimore si: parimi i ekonomizimit të procedurës dhe parimeve të tjera të kësaj procedure. Njëkohësisht përbërja e trupit gjykues me rastin e vendosjes së çështjeve civile-juridike ndikon dukshëm në rritjen e azhuritit dhe efikasitetit të gjykatave, duke mundësuar vendosjen dhe përfundimin e procedurës në një hark më të shkurtër kohorë.

LITERATURA

Brestovci, F. (2002). E drejta procedurale civile I Prishtinë

Brestovci, F. (2006). E drejta procedurës civile II Prishtinë

Hasani, E. (2010). Ne bis in idem në procedurën kontestimore Prishtinë

Morina, I., & Nikqi, S. (2012). Komentar – Ligji për Procedurën Kontestimore LPK Prishtinë

(2008). Kushtetuta e Republikës së Kosovës Prishtinë

(2008). Ligji për Procedurën Kontestimore Prishtinë

(2006). Ligji për Familjën Prishtinë

(2004). Ligji për Drejtën e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta Ligji nr. 2004/45.

(1997). Ligji mbi Procedurën Kontestimore Prishtinë